

AKT THEMELIMI
Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“XHULJA 2022” sh.p.k

Sot, më datë **28.09.2022** u paraqiten personalisht:

1. Znj. Xhulja Shëmbitraku me nr. Personal J45704072O, lindur ne Librazhd, ne date 04/07/1994 dhe banuese ne Durres.

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe ne liri te plote ne baze te ligjeve shqiptare, themelon shoqerine me përgjegjesi te kufizuar **“XHULJA 2022”** Shpk si vijon:

Neni 1

Personi i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe me liri të plotë në bazë të ligjeve shqiptare, themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar **“XHULJA 2022”** sh.p.k.

Ortaku i kësaj shoqërie do te jete:

1. Znj. Xhulja Shëmbitraku me nr. Personal J45704072O, lindur ne Librazhd, ne date 04/07/1994 dhe banuese ne Durres zoterues i një kuote me vlerë 100.000 All.

Administratori emerohet per një periudhe 5 vjeçare dhe do te jene:

1. Znj. Xhulja Shëmbitraku me nr. Personal J45704072O, lindur ne Librazhd, ne date 04/07/1994 dhe banuese ne Durres.

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do të konsiderohet i përshtatshëm nga ana e saj dhe me aprovimin e organeve kompetente (Qëndra Kombëtare e Regjistrimeve).

Neni 2

Shoqëria **“XHULJA 2022”** sh.p.k gjëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi. Selia e shoqerise do te jete **Lagjja “Clirim”, Lushnje, kat.0, Dyqani nr 4, Pasuria nr 2/75-N4, Zona Kasastrale 8571 me siperfaqe 128.3 m², Lushnje**.

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij. Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin **“XHULJA”** sh.p.k.

Neni 3

Aktiviteti i shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet.



Neni 4

Shoqëria ka si objekt aktiviteti:

1. Prodhim, montim të motorëve elektrikë, për llogari ~~te~~ vetën dhe për palët e treta, rafinim per brenda vendit dhe per import-eksport ne regjimi e perpunimit aktiv (fason). Blerje dhe shitje e metaleve me ngjyra. Konsultimi ~~te~~ krijimi i raporteve teknike dhe këshillimit për çështje finaciare, ekonomike ~~te~~ teknike për specifikimet dhe kompetencat e administratorit dhe personelit ~~te~~ punësuar (bankare, financiare, ekonomike, inxhinerike-elektronike dhe civile ~~te~~ qëllim krijimin e studimit dhe konsulencës.
 2. Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet e ~~njojshme~~ per zbatimin e objektit te shoqerise dhe midis te tjera:
- Te kryeje veprime tregtare dhe industriale, ~~financiare~~, hipotekore dhe pasurive të patundshme duke perfshire blerjen, shitjen dhe shkëmbim e pasurive te patundshme te luajtshme, edhe te regjistrues, pasurive të ~~paluajtshme~~ dhe të drejtave pasurish te paluajtshme, qiramarrje dhe me qiradhenie aktive ~~te~~ pasive të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, me përjashtim e qirave aktive ~~financiare~~;
 - Te zbatoje cdo formë të financimit (si dhe leasing-ut pasiv) me institutet e kredive, bankave, shoqerive dhe privateve, duke dhene garantie e nevojshme reale dhe personale;
 - Te japë garanci bankare, kambiale dhe garanci ~~reale~~ në favor të shoqerive kontrolluese, te kontrolluara dhe te lidhura dhe te kontrolluara ~~ngj~~je e vetme qofte edhe ne brendesi te te njejtit grup;
 - Të marri pjesë në konsorciume ose grupime ~~shoqerish~~ dhe asocim te perkoheshem shoqerish;
 - Të marrë pjesëmarrje dhe fitime ne shoqeri ~~e~~ndermarrje sipas dispozitave ligjore gjithnjë ne funksion te qellimeve te shoqerisse, por ~~ja~~ne menyre eksluzive.
- Shoqeria mund te perdore perfitimiet fiskale, ~~shoq~~ore dhe financiare te parashikuara sipas ligjeve ne fuqi me ndryshimet e tyre, shtyrjet ~~te~~ modifikimet, per aktivitetin ne objekt, si dhe nga cdo ligj tjeter lethesues, si ~~te~~ lethesimet e parashikuara nga Komuniteti European.

Neni 5

Kapitali i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqind mijë) Lekë , i përbërë nga 1 kuote, me vlerë 100.000 Lek.

Neni 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga aktiviteti i ~~te~~ shoqërie, nëse do të shpërndahet, do t'i caktohet ortakëve në bazë të kuotave të pjesëmarrjes ~~te~~ disponojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 7

Për detyrimet ndaj të tretëve që do të krijojnë ~~te~~ aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet eskluzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ~~ont~~ët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përvëçse brenda kufijës ~~te~~ kapitalit të vetë shoqërisë.

Neni 8



Neni. 8 – Efikasiteti i vendimmarrjes së asamblesë

8.1 Asambletë e formuara dhe të thirruara rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e têrheqjes sic parashikohet në ligj.

Neni. 9 – Thirrja dhe vendi i Asamblesë

9.1 Asambleja e ortakëve, e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve, këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit, nëse ata janë emëruar të paktën tetë ditë përpara datës së fiksuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i interesuar i ka dhënë shoqërisë.

9.2 Lajmërimi i thirrjes duhet të përbajë përshkrimin e ditës, orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe argumentet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

9.3 Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

9.4 Ne baze te nenit 83 Ligj 9901 date 14/04/2008 lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e këtij njoftimi.

Art. 10 – Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble

10.1 Mund të ndërhyjnë në asamble të gjitha ata që rezultojnë të jenë ortakë në datën e asamblesë.

10.2 Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një prokure të shkruar të dorëzuar ose me fax ose me postë elektronike nga një person tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak.

10.3 Prokura nuk mund të lëshohet e pashkruar.

Neni. 11 – Presidenti i asamblesë

11.1 President i asamblesë është ose administratori i vetëm ose nga presidenti i këshillit të administrimit, në rastin e emërimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përzgjedhur nga asambleja.

11.2 Për të arritur tek kjo përzgjedhje mbledhja duhet të drejtohet përkohësisht nga personi me moshën më të madhe i cili është i pranishëm në asamble.

11.3 Asambleja zgjedh sekretarin dhe nëse është e nevojshme dy komisioner.

11.4 Ne mbashtetje nenit 90 Ligj 9901 date 14/04/2008 vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të firmosur nga presidenti dhe sekretari i; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.

11.5 Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e mbajtjes së asamblesë, certifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishëmve, rregullon zhvillimin e saj dhe certifikon rezultatet e votimeve.

Neni. 12 – Vendimet e asamblesë

12.1 Mbështetur ne nenin 86 te Ligjit 9901 te dtes 14/04/2008, Asamblea ngrihet rregullisht me prezencen e shumices se orakeve qe perbejne me shume se 30% te kapitalit te shoqerise. Ne rastet e parashikuara nga neni 87 I Ligjit 9901 te dates 14/04/2008 dhe per kete vendimet qe lidhen me modifikimet e statutit, per veprimet e shtimit apo reduktimit te kapitalit, shperndarjes se fitimive dhe riorganizimit apo shuarjes se shoqerise, asambleja konsiderohet e mbledhur ne menyre te rregullt nese ne te jane prezent shumica e ortakeve qe perbejne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise. Nese nuk arrihet kuorumi I parashikuar nga neni i meparshem 12.1 asamblea duhet te rimblidhet brenda 30 diteve.

12.2 Pervec rasteve ku ligji apo statute parashikon ndryshe, asambleja e mbledhur rregullisht, merr



vendime me voten pro te ortakeve qe perbejne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise .

12.3 Për më tepër, mbi vendimet e parashikuara ne nenin 87 te ligjit 9901 te dates 14/04/2008 asambea vendos me voten pro te me shume se 75% ortakeve.

TITULLI IV

ADMINISTRIMI DHE PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni. 13 – Administrimi i shoqërisë

13.1 Bazuar ne nenin 95 te Ligjit 9901 te dates 14/04/2008, shoqëria administrohet, në varësi të asaj që vendoset herë pas here nga asambleja e ortakëve, nga një administrator i vetëm ose nga një këshill administrativ i përbërë nga dy ose pesë anëtarë , të emëruar edhe midis atyre të cilët nuk janë ortakë. Mbeshtetur ne nenin 95 pika 5 te ligjit 9901 date 14/04/2008, ne rastin kur shoqeria do te administrohet nga me shume se një administrator i vetem, ne formen e keshillit te administrit apo jo, administratoret mind te veprojne ne menyre te pavarur nga njeri tjetri.

Administrator i shoqerise emerohet:

1. Znj. Xhulja Shëmbitraku me nr. Personal J45704072O, lindur ne Librazhd, ne date 04/07/1994 dhe banues ne Durres.

13.2 Kohëzgjatja në detyrë e administratorit eshte 5 vjecare e rinvueshme. Ne cdo rast, ne cdo moment domethene edhe para perfundimit te mandatit administratoret mund te revokohen edhe pa shkak.

13.3 Shpërblimi dhe pjesmarrja në fitime e administratorit të vetëm dhe anëtarëve të këshillit administrativ përcaktohen nga ortakët.

13.4 Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsyet e detyrës së tyre.

13.5 Shpërblimi i administratorëve të veshur me detyra të posacme, dhe gjithsesi të ndonjë administratori të deleguar, përcaktohet nga këshilli administrativ.

Neni. 14 – Presidenti, zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar

14.1 Në rastin e emërimit të një këshilli administrativ, nëse nuk e kanë bërë ortakët, ky i fundit zgjedh midis anëtarëve të tij presidentin, zv. presidentin i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pamundësie të tij me fuqitë dhe kufizimet të përcaktuar kohë pas kohe nga këshilli administrativ.

Neni. 15 – Vendimet e këshilit administrativ

15.1 Vendimet e këshillit administrativ merren me mbledhje kolegiale.

15.2 Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

Neni. 16 – Mbledhja kolegiale e këshillit administrativ.

16.1 Këshilli administrativ do të mblidhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjeter në Shqipëri ose jashtë, cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

16.2 Si rregull thirrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa

kohë që mund të provohet marrja e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

16.3 Këshilli administrativ mund të mbahet rregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpermendura, nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e oranit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar, pa anashkaluar të drejtën e secilit pjesmarës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsideron se nuk është informuar mjafsheshëm.

16.4 Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarries si më poshtë: duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistanca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

16.5 Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të jenë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japid vota kundër ose abstenojnë, vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

Neni. 17 – Vendime të marra me mbledhje kolegiale

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posacëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

Neni. 18 – Fuqitë e organit administrativ

18.1 Bazuar ne nenin 95 te Ligjit 9901 date 14/04/2008 organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrit, me përashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca eksluzive të vendimeve të ortakëve.

18.2 Këshilli i administrit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme, automjete, ti përfshijë në shoqëri, të marrë aksione dhe interesa, të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh, drejtorë e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë një pjesë ose të gjithë atributet dhe fuqitë e tij dhe ato të presidentit, përfshirë edhe firmën e shoqërisë, njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij duke mirëpërcaktuar atributet ose penalitetet si edhe shpërblimet në kufijtë dhe format që ai do ta gjykojë të përshtatshme.

Neni. 19 – Firma dha përfaqësimi i shoqërisë

19.1 Përvec rasteve të parashikuar në artikullin e mëparshëm 18.3, firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ.

TITULLI V

ORGANI I KONTROLIT

Neni. 20 – Organ i kontrollit.

20.1 Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet dhe të kryhet sipas zgjedhjes dhe me vendim të pronarëve nga një ekspert kontabël. Eksperti kontabël mund gjithashtu të pushohet nga puna nga asambleja e ortakëvë.

TITULLI VI

BILANCI – FITIMET

Neni. 21 – Ushtimi i shoqërisë, Bilanci dhe fitimet.

21.1 Ushtrimet e shoqërisë mbyllen më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të cdo viti. Ushtimi i parë mbyllt më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2022 (dymijë e një e dy).

21.2 Bilanci i hartuar në konformitet me normat e patjetëruara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përvèc mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen këtu:

- 10 % (pesë për qind) në ngritjen e një fond rezervë ligjore, deri në arritjen e një shume të barabartë më një të pestën e kapitalit të shoqërisë;
- Fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihet menjë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast, nesë verifikohet humbje kapitali, nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

TITULLI VII

SHKRIRJA, PERJASHTIMI I ORTAKEVE, LIKUDIMI DHE MOSMARRVESHJET

Neni. 22 – Shkrirja

22.1 Shoqëria quhet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuar nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë, ortakët do të përcalojnë një ose më shumë likujdues dhe do caktojnë fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

Neni. 23 – Dispozita të përgjithshme

23.1 Për gjithëka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut, do të bëhet kohë pas kohe një referim i shprehur i ligjeve fuqi.

ORTAKU I SHOQËRISË

XHULJA SHËMBITAKU

